



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:110779

Datë: 04.11.2024

Numri i dokumentit: 06394446

C.nr.1013/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Binak Duqi, dhe bashkëpunëtorin profesional Mensur Avdullahu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F. H. me nr. Personal me vendbanim në L. i P. – P., të cilën e përfaqëson i autorizuari av. A. H. avokat nga P. adresa Rr: “N. K.” nr.. Hy..., H.-P. me autorizim, kundër të paditurës Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit nga P., Rruga “N. G.” pn., me objekt kontesti: Kompensimin e Inflacionit në pagën bazë, me vlerë të kontestit: **906.79 €uro**, jashtë seance me dt.02.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
- pa shqyrtim kryesor të çështjes -

I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditëses F. H. nga P., **si e bazuar**, dhe:

II. DETYROHET e paditura Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit në P., që paditëses t’ia kompensojë shumat në emër të Inflacionit në pagën bazë dhe atë si ne vijim:

- Për periudhën Maj-Dhjetor 2020, për $0.2\% \times 421 \text{ €}$ (paga bazë) = $0.842 \times 8 \text{ muaj} = 6.73 \text{ €}$.
- Për periudhën Janar-Dhjetor 2021, për $3.4\% \times 421 \text{ €}$ (paga bazë) = $14.314 \times 12 \text{ muaj} = 171.76 \text{ €}$.
- Për periudhën Janar-Nëntor 2022, për $11.60\% \times 421 \text{ €}$ (paga bazë) = 48.83×10.66 (10 muaj e 20 ditë) = 520.59 € .

Në total shuma e aprovuar në emër të kompensimit të inflacionit prej **699.08 €urove**.

III. Refuzohet kërkesa e paditëses përtej shumes se aprovuar dhe atë për shumën tjetër të kërkuar prej 207.71 €, i refuzohet si pa bazuar dhe e (parashkruar).

IV. DETYROHET e paditura që shumat e aprovuara, paditësit t’ia paguaj me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar ti llogaritet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 174.00 €uro, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarrimit.

V. REFUZOHET kërkesa e paditësit për kamatë ligjore prej 8 % qe ajo ti llogaritet nga data e parashtrimit të padisë e deri ne pagesën definitive.

A r s y e t i m

Paditësja F. H., përmes te autorizuarit të tij, me datë 17.05.2023, në këtë gjykatë ka paraqitur padi kundër të paditurës për kompensimin në emër të kërkesave të përshkuara dhe shumën e përgjithshme, si në pjesën hyrëse të këtij aktgjykimi.

Ka shtuar se paditësi është në marrëdhënie të rregullt pune apo ka qenë te e paditura si mësimdhënës në “Z. H.” në P., dhe se e paditura përkundër obligimeve, përkatësisht fitimit të të drejtave të cilat rrjedhin nga Kontrata kolektive e Arsimit në Kosovë, e datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, konkretisht nenit 35 paragrafit 10 të saj, si dhe Ligjit të Punës konkretisht nenit 55 par 1 të tij dhe Ligjit për Arsimin në Komunitet e RK – së nenit 4 par. 1, e paditura përkundër obligimit që rrjedh nga kjo bazë ligjore nuk ka bërë kompensimin e inflacionit në emër të kërkesave të paditëses sipas Entit të Statistikave të Kosovës, ashtu siç janë precizuar edhe në parashtrësën e datës 22.11.2023.

Andaj, i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar dhe ta detyroj të paditurën që të bëjë kompensimin e shumës së precizuar në emër të kërkesave të lartcekura.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi të datës 01.11.2024, i ka pohuar faktet vendimtare duke theksuar se e konteston kërkesëpadinë e paditësit, për kompensimin në emër të kërkesave të tij. Ka theksuar se padia nuk ka bazë juridike, ngase me dispozitat kalimtare të kontratës kolektive në fuqi nga dt.18.04.2017 dhe 22.01.2021, në nenin 46 të saj është paraparë se MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për t’i informuar dhe ndihmuar Komunitet që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për pagesën e obligimeve që rrjedhin nga neni 35, andaj e paditura nuk ka buxhet për kryerjen e obligimeve ndaj punëtorëve. Ka shtuar se kjo kontratë kolektive sipas nenit 90.5 të ligjit të punës, vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me kontratën kolektive, e në rastin konkret e paditura nuk është nënshkruese kësaj kontrate. Ka shtuar se kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës së paditësit komform nenit 87 të Ligjit të punës dhe paditëses duhet ti hiqen 10 muaj për shkak të parashkrimit. Ka theksuar se paga baze e paditëses është 421 e jo 455.10 €.

Andaj, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 152 i Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se: *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundërt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim”*, lidhur me nenet 143 dhe 147 të të njëjtit ligj, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij, dhe ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.

Gjykata, duke pasur parasysh faktin se i padituri i ka pohuar faktet vendimtare, përkundërt kontestimit të kërkesëpadisë, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura me disa vite përvojë pune, po ashtu nuk është kontestuese se e paditura nuk i ka paguar paditëses kompensimin në emër të kërkesave të tij, pasi që një gjë e tillë nuk kontestohet nga palët, kjo vërtetohet dhe me provat materiale në shkresat e lëndës.

Andaj, gjykata, komform nenit 152 dhe 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke iu referuar dispozitave të

Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e dt.18.04.2017, konkretisht nenin 35 par.10 të njëjtit nen ku është përcaktuar se: *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë.”*, por këtë nuk e ka bërë e paditura edhe pse ka qenë e obliguar ta bëjë këtë.

Po ashtu kjo është e rregulluar me Ligjin nr.03/L-212 e Punës, sipas nenit 90 par.4 të tij ku thuhet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se 3 (tri) vjet.”*, siç është dhe me këtë Kontratë (e cila ka qenë në fuqi komform nenit 45 par.2 të saj, deri me datën 22.01.2021), e që kjo çështje është rregulluar njëjtë dhe me dispozitat e nenit 35 par.10 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë në fuqi nga data 22.01.2021 të cilat gjejnë zbatim në rastin e paditësit, si dhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës GJ.A-Su.A.214/2023 të datës 05.10.2023, i cili në pikën II, ka përcaktuar se: *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, Sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve.”*, por këtë nuk e ka bërë e paditura edhe pse ka qenë e obliguar ta bëjë këtë.

Gjykata lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë vendosi duke u bazuar në Kontratën e Punës Nr. protokolli 05-1-1645 të datës 01.05.2017, Vërtetim Nr. Prot. 332/23 i datës 13.11.2023 lëshuar në emër të paditësit nga SHFMU “Z. H.” ne L. – P., si dhe liste e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës nga e cila vërtetohet se paditësja ka realizuar pagën baze ne shumen prej 421€, me ç ‘rast kemi të bëjmë me dokumente publike të cilat kanë fuqi të plotë provuese, e që në anën tjetër e paditura nuk i ka rrëzuar me prova materiale fuqinë provuese të këtyre dokumenteve, e gjithë kjo dhe bazuar në dispozitën e lart cituar të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, konkretisht nenit 35 par.10 të saj dhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës GJ.A-Su.A.214/2023 të datës 05.10.2023.

Gjykata i konsideron si të papranueshme dhe të pabazuara pretendimet dhe kundërshtimet e të paditurës se ajo nuk ka asnjë obligim ndaj paditësit me arsyetim se nuk ka buxhet për të bërë këto pagesa në emër të kërkesave të paditësit, se nuk është nënshkruese e kontratës, për çka edhe i ka propozuar gjykatës që padia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Ndërsa gjykata ja refuzoi kërkesëpadinë paditëses F. H., përtej shumave të aprovuara të shtesës në pagë për shkak të Inflacionit si të pabazuar, dhe atë për 16 muaj, apo shumën totale prej 207.71 €. Gjykata, një pjesë të shumës se lartcekur e refuzoi si ta pabazuar dhe atë duke e llogaritur për periudhën nga data 01.09.2019 e deri më 30.04.2020, meqë gjykata në kuptim të rrethanave të konstatuara me lart dhe duke e vlerësuar prapësimin e të paditurës në lidhje me parashkrimin, bazuar në provat e paraqitura, gjeti se kërkesa për këtë periudhë është parashkruar. Kjo komform dispozitës së nenit 87 të LP-së, ku lidhur me kërkesat në para nga marrëdhënia e punës është paraparë afati i parashkrimit, ashtu që është përcaktuar se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruben brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.”*. Duke pasur parasysh se parashkrimi fillon të rrjedhë nga dita e parë pas ditës kur paditësi ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, gjykata konstaton se në rastin konkret kemi parashkrim për pjesën e kërkesave të lartcekura. Në rastin konkret, për periudhën 01.01.2019 deri më 30.04.2020, deri në ngritjen e padisë me 17.05.2023, për realizimin e shtesës në pagë për shkak të Inflacionit, kanë kaluar mbi 3 vite, me çka është parashkruar kjo pjesë e kërkesës për këtë periudhë. Ndërsa pjesën tjetër ia refuzoi si te pabazuar për faktin se paditësja kompensimin e Inflacionit e ka llogaritur me pagën bazë 455.10 €, e siç vërtetohet nga lista e pagave te bashkangjitur paditësja ka realizuar pagën baze ne vlere prej 421.00 € e jo 455.10 €, andaj iu refuzua kërkesa e lartcekur si e pabazuar.

Kamatëvonesa është vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 382 të Ligji Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e palëve dhe provat tjera të ofruara, por vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes kontestimore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449, 450, 452 dhe 453.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore si dhe Rregullores për Tarifat e Avokatëve e Odës së Avokatëve të Kosovës (2017). Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara u referohet për përpilimin e padisë shuma prej 104 euro, për parashtresën për precizimin e kërkesëpadisë shuma prej 50.00 €, si dhe taksave gjyqësore të paguara për padi në shumë prej 20.00 eurove, apo gjithsejtë shuma prej 174.00 €, duke marrë për bazë vetëm ato shpenzime të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjykatë.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e cekura më lartë.

**Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1013/2023, me datën 02.11.2024**

Gjyqtari :
Binak Duqi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.